



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Integritim Evropian**

**Mbledhja nr. 61**

**Prishtinë, më 14. 12. 2016, në orën 10:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, S-2**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Arben Gashi, Fatmir Xhelili, Vjosa Osmani, Bislam Zogaj, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Time Kadrijaj.**

**Munguan: Xhavit Haliti-(udhëtim zyrtar), Valdete Bajrami-(udhëtim zyrtar), Kujtim Paqaku-(udhëtim zyrtar) dhe Slobodan Petroviq.**

**Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.**

**Mbledhjen e kryesoi Njomza Emini, kryetare e Komisionit.**

**Në mbledhje u propozua ky:**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 29.11.2016;**
- 3. Takimi informues me znj. Nataliya Apostolova, udhëheqëse e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Përfaqësuese Speciale e Zyrës së BE-së në Kosovë, për Raportin për Kosovën 2016;**
- 4. Shqyrtimi i Agjendës për Reforma Evropiane (ARE);**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 7. Të ndryshme.**

**Kryetarja e komisionit pasi konstatoj se u plotësuan kushtet për punë hapi mbledhjen.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

**Rendi i ditës u miratua pa ndryshim.**

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.11.2016**

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtura më 19.11.2016, u miratua pa vërejtje.

## **3. Takimi informues me znj. Nataliya Apostolova, udhëheqëse e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Përfaqësuese Speciale e Zyrës së BE-së në Kosovë, për Raportin për Kosovën 2016**

**Kryetarja e Komisionit, Njomëza Emini**, e hapi takimin duke e falënderuar z. Apostolova për bashkëpunim, dhe u zotua se Komisioni do të angazhohet që t'i përmbushë obligimet, jo vetëm si mbikëqyrës i Qeverisë, por edhe si pjesëmarrës me të gjithë aktorët relevant për ta arritur synimin përkitazi me anëtarësimin e Kosovës në BE.

**Përfaqësuesja speciale e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalia Apostolova**, prezantoi Raportin e Progresit dhe të gjeturat e Zyrës së BE-së për Kosovën për vitin 2016.

Ajo theksoi se i vije mirë që pas dy muajve prapë po takohet me Komisionin për Integritet Evropian. Viti 2016, ka qenë një epokë për Kosovën, dhe pamjet e dhunshme në Kuvend i dhanë imazh të keq i vendit në dy vitet e fundit.

"Polarizimet në mes të Qeverisë dhe opozitës që shpesh herë kanë eskaluar edhe në dhunë, është në kundërshtim me frymën evropiane. Kuvendi është vendi ku liderët politik duhet të tregojnë përgjegjësi për votuesit e tyre".

Ajo më tej u shpreh se duhet bashkëpunim më i madh në mes deputetëve, ndërkaq, duke iu referuar listës serbe, atyre u bëri thirrje që të kthehen në Kuvend dhe të kontribuojnë për komunitetin e tyre.

Apostolova, kritikoi edhe Kuvendin e Kosovës për mospërfilljen e procedurave gjatë miratimit të ligjeve.

**Donika Kadaj- Bujupi** e falënderoi znj. Apostolova për gatishmërinë dhe tha se ne jemi mirënjohës për këtë transparencë dhe vullnet të mirë nga ana e juaj që të raportoni në vazhdimësi, por tha se ne kemi problem me transparencën dhe raportimit nga ana e Qeverisë, shumë çështje jetike kanë mbetur të mbyllura dhe Rezolutat e Kosovës janë injoruar dhe janë bllokuar në mungesë të transparencës.

Përderisa kemi qenë në një proces goxha të gjatë të dialogut me qëllim të integritetit të serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës, ne po shohim që si rezultat i këtyre bisedimeve ose për gjatë këtyre bisedimeve po ngrihet një mur i cili po e ndanë qytetin e Mitrovicës përfundimisht. Ne, dje, kishim një deklaratë të ministres për Dialog e cila tha që muri do të hiqet bashkë me BE, sepse është një projekt të cilin Qeveria nuk ka nënshkruar dhe e kundërshton dhe do të hiqet në bashkëpunim me BE-në.

Duke marrë parasysh që shumë shpesh kemi deklarata të pavërteta, nëse mundemi sot me e ditë cili është qëndrimi i juaj dhe a do të hiqet ashtu siç po thotë Qeveria bashkë me BE-në, apo këto janë deklarata siç ka ndodhur edhe vitin e kaluar të pavërteta për projekte të dëmshme të cilat më vonë nuk mund të implementohen dhe të cilat po ndikojnë në gjendjen e përgjithshme në vend dhe sigurisht që pastaj po mbërrin në faza kur deputetët e opozitës po zvarriten nëpër gjykata siç na ndodhi edhe sot para se të vijmë këtu. E ndërkohë që projektet e dëmshme nuk mund dhe nuk duhet të realizohen si të tilla.

**Vjosa Osmani** e falënderoi dhe i dëshiroi mirëseardhje duke theksuar se është një freski në raportet mes Kuvendit të Kosovës dhe Bashkimit Evropian që t'ju kemi sa më shpesh këtu dhe të diskutojmë çështje të interesit të përbashkët, por në veçanti që prekin jetën e qytetarëve të

Kosovës. Po lidhem te çështja e murit të ndërtuar e cila nuk është e lidhur drejtpërdrejtë me raportin për vendin, por nga analiza ime e raportit është e lidhur drejtpërdrejtë, duke filluar nga pjesa e parë që vetë Bashkimi Evropian e ka identifikuar si më të rëndësishëm, demokracia faqe 6 ku qëllimisht çështja e Veriut identifikohet ndër çështjet themelore dhe aty thuhet që situata në veri mbetet e qetë që ka përmirësim në komunikimin mes kryetarëve në veri dhe institucioneve qendrore dhe që punët e ndërtimit në Urën e Mitrovicës filluan me qëllim të hapjes së urës për gjithë trafikun.

Edhe pse në këtë raport thuhet diçka që për mua është të jetë shqetësuese në po të njëjtin paragraf, pra ndërtimi i Urës, hapja e Urës për trafik është çështje të jetë simbolike. Absolutisht nuk është simbolike, të trajtohet si e tillë nga Bashkimi Evropian apo kushdo në Republikën e Kosovës sepse na çon drejt problemeve të reja.

Pjesa e ndërtimit të murit lidhet drejtpërdrejt edhe me kapitullin për të drejtat e njeriut. Për vite të tëra qytetarëve në veri të Mitrovicës, në veçanti shqiptarëve, boshnjakëve, turqve dhe disa komuniteteve të tjera, u është mohuar në mënyrë flagrante liria e lëvizjes, mbrojtja e pronës, e drejta në jetë dhe e drejta në liri dhe siguri. Pra, nuk ka fort dallim nga ajo se si kemi jetuar shumë prej nesh gjatë kohës së luftës. Kjo është shqetësuese, sepse si rezultat i kësaj ne kemi deklarata sikur ato që i dëgjuam më herët, qoftë nga zyrtarët e Qeverisë, qoftë nga zyrtarët e Bashkimit Evropian, që në qoftë se më lejohet ta citoj ashtu si është thënë në media që “nuk do të ketë mur, por do të ketë shkallë”.

Në fakt murin veç e kemi, kështu që ndoshta dikush mundet për ta shpjeguar logjikën e ndërtimit edhe të shkallëve për t’i lidhur dy pjesë të rrafshëta.

Madje, edhe çështja e barazisë gjinore që ju e keni përmendur, nuk trajtohet në komunat në veri. Çështje e cila është injoruar përkundër faktit që është dëshmuar që gratë e Kuvendit të Kosovës kanë qenë politikanet e vetme me të cilat qytetarët e veriut kanë pranuar të flasim për problemet e tyre. Kjo më lidh me çështjen e dialogut Kosovë – Serbi meqenëse ju kërkuat nga ne që të jemi konstruktiv dhe unë pajtohem plotësisht me juve, si një përkrahëse e procesit të dialogut, sepse mendoj që është e vetmja mënyrë për të zgjedhur problem me çdo shtet, po në veçanti me Serbinë.

Mirëpo, më lejoni t’i përmend dy-tri çështje që patjetër do të duhej të adresoheshin besoj edhe nga institucionet tona, por edhe nga ju. E para, është që konstruktiviteti është i mundshëm vetëm për dokumentet që mundesh me i pa, por për neve shumica e dokumenteve mbesin të fshehta. Ne duhet të kontaktojmë me gazetarë në Bruksel, me zyrtarë me të cilët kemi raporte për të marrë vesh se çka po diskutohet e nganjëherë marrim edhe mesazhe konfliktuoze rreth asaj se çka është e vërteta dhe cila është marrëveshja.

Çështja e dytë, kur është miratuar Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme për dialogun thuhet shumë qartë se qëllimi i këtij dialogu është që të zgjidhen problemet e qytetarëve të shtetasve të të dyja palëve, pra Kosovës dhe Serbisë. Qëllimi ka qenë t’i ju ndihmojmë qytetarëve dhe unë mendoj që duke e bërë historik çdo shtrëngim duarsh e kemi anashkaluar totalisht analizën e rezultatit në terren të këtyre marrëveshjeve. Kemi harruar ta analizojmë në qoftë se vërtetë ato po kthehen në përmirësim praktik të jetës së qytetarëve dhe kushdo që flet me qytetarët e Mitrovicës, qofshin ata që jetojnë në jug, qofshin ata që jetojnë në veri do ta dëgjojnë të njëjtën storie dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me urën, nuk ka të bëjë vetëm me muret.

Por, unë vazhdoj të mendoj që mënyra e vetme për t’i integruar këto komunitete është zhvillimi ekonomik dhe kur punojnë bashkë komunikojnë dikur problemet do të zgjidhen.

E fundit, sa i përket Kuvendit të Kosovës, sa i përket procedurës së përshpejtuar dhe për këtë i kam informuar edhe zyrtarët nga BE-ja që e mbulojnë Kuvendin, shumë herë njerëzit që janë në Kuvend dhe insistojnë që të shkojmë në procedura të përshpejtuar thirren me emrin tuaj. Pra, thonë votoni 20 ligje përnjëherë se kështu po kërkon BE-ja.

Pra, ta keni këtë parasysh, sepse unë e kam thënë edhe në Kuvend çdo herë ju po thirrni në emër të BE-së, por BE-ja në çdo vjet në raportet e progresit po na kritikon për të njëjtat veprime.

Kështu që është mirë që kjo çështje të qartësohet që në qoftë se kjo nuk është e vërtetë, pra në qoftë se BE-ja nuk po kërkon procedura të përshpejtuara, atëherë të mos lejohet që asnjë politikan në Kuvendin e Kosovës të thirret në emrin tuaj, sepse shembullin e Buxhetit që e dhatë ju, në vitin e kaluar për shembull, nuk është lejuar asnjë deputet as të bëjë amendamente. Ndoshta, dikush e ka shfrytëzuar këtë të drejtë, mirëpo thujse asnjë nuk është shqyrtuar, për shkak të procedurave të përshpejtuara.

Në fund tha se pasi të gjitha këto ishin komente, patjetër të ndikuara nga situata e fundit, pyeti znj. Apostolova „A mund ta sqaroni qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian lidhur me ndërtimin e murit në urën e Mitrovicës, për shkak se mendoj që kjo e pengon progresin për të gjitha fushat e tjera të adresuara në dokumentin të cilin po e diskutojmë? A mund ta sqaroni çfarë nënkupton “nuk do të ketë mur, por do të ketë shkallë.” A do të thotë kjo që, siç e tha kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, që ai mur në tërësi do të rrënohet? A është ky qëndrim i Bashkimit Evropian?

**Time Kadrijaj** e falënderoi znj. Apostolova që ka ardhur për të diskutuar për raportin e progresit. Ajo tha se kishte qenë mirë që në këtë pjesë të njoftohet edhe populli i Kosovës lidhur me mos liberalizim të vizave, sepse gjatë vizitave të fundit që kemi bërë në Bruksel dhe Strazburg, gjithmonë ne, si Komision, kemi thënë se është e padrejtë që jemi krahasuar me Gjeorgjinë dhe Ukrainën, por tash po ndodh krejt e kundërta, ato dy shtete morën liberalizim të vizave, edhe pse e dimë që situata atje është shumë më e ndërlikuar dhe shumë më e keqe, janë vende ku ka luftë, ku shkelen tërësisht të drejtat e njeriut, ku s’janë të përcaktuar kufijtë dhe në fakt, janë me numër më të madh të banorëve se sa Kosova, ndërsa ato morën liberalizimin e vizave dhe Kosova jo.

Ajo e pyeti znj. Apostolova: Pse për Kosovën po përdoren standarde të dyfishta? Pse për Kosovën po ka standarde ekstra në raport me vendet tjera, të cilat kanë marrë liberalizimin e vizave?

Situata në Kosovë vërtet nuk është e mirë, s’jemi të kënaqur as ne, si politikanë, por as populli dhe shumica e këtyre gjërave që po ndodhin në Kosovë është faji për mos transparencën e Qeverisë së Kosovës.

E vetmja mundësi ku Qeveria duhet të jetë transparente është Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet pyetjeve parlamentare që u drejtohen oponentëve qeveritarë dhe nëse merrni një raport nga Kuvendi, se sa ju kanë përgjigjur ministrat pyetjeve parlamentare që u parashtrajnë deputetët, do ta shihni se është alarmante dhe të mos flasim për marrëveshje të rëndësishme të veçantë, që ka qenë demarkacioni dhe asociacioni i komunave serbe, ku fare nuk është bërë transparent i gjithë procesi dhe në momentin kur ka ardhur, ka qenë i gatshëm, veç sa për një raportim formal dhe shkaku pse është kundërshtuar është mos transparenca.

Tash po ndodh me ndërtimin e murit në Urën e Ibrit, ku tash është e pakuptimtë kur qeveritarët dalin me deklaratat konfuzë dhe asnjëri nga këta, qoftë kryeministri apo ministrja për dialog nuk e kanë një deklaratë për t’i treguar popullit dhe neve, se çfarë po ndodh me të vërtetë.

Të gjithë jemi të interesuar për agjendën evropiane dhe në fakt po mundohemi të kontribuojmë, kemi ofruar gatishmërinë tonë sepse edhe populli ynë meriton me qenë si gjithë popujt e tjerë dhe dëshiron të integrohet në të gjitha proceset evropiane.

Te sundimi i ligjit dhe luftimi i krimit dhe korrupsionit, përpos Kosovës, fajtor ndoshta është edhe EULEX-i, se e ka në përgjegjësinë e vet me u futur në luftimin e krimit dhe korrupsionit, i ka të gjitha kompetencat, nëse është ky një kriter për liberalizimin e vizave, edhe EULEX-i duhet të përgjigjet, përse s’po luftohet mjaftueshëm krimi i organizuar dhe korrupsioni.

Shqetësuese mbetet edhe çështja e veteranëve të Kosovës, Është një kategori e cila vërtet në Kosovë ka ngelur pas dore dhe para një viti është miratuar Ligji për veteranët e Kosovës dhe një pjesë dhe një kategori e tyre kanë filluar t’i marrin benefitet. Këtë problem duhet ta zgjidhë qeveria, pra ministria përkatëse, bashkë me veteranët, në mënyrë që të gjejë një zgjidhje të duhur, normalisht duke mos u dëmtuar as veteranët, por as shteti i Kosovës.

Dhe në fund pyeti znj. Apostolova, cili është qëndrimi juaj për murin që është ndërtuar në Ibër. A është kjo marrëveshje? A ekziston një marrëveshje prapë nga qeveritarët tanë, apo është një veprim ad-hoc i qytetarëve në veriun e Mitrovicës.

**Fatmir Xhelili** fillimisht falënderoi znj. Apostolova dhe ekipin e saj për raportin, i cili tha se është objektiv dhe ka identifikuar të metat, lëshimet dhe dobësitë dhe vlerësoi se ka filluar të jetë gjithnjë orientues për përcaktimin e politikave të shtetit tonë në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin prej këtyre raporteve.

Mund të them se në shtetin tonë janë grumbulluar shumë probleme edhe të tri-katër gjeneratave, në drejtimin funksional dhe në drejtimin politik, po edhe në drejtimin e problemeve ekonomike e të mos flas për sundimin e ligjit e të tjerat. Gjetjet do t'i nënvizojmë për prioritetet tona politike për reformën, për agjendën e reformës evropiane dhe kjo do të na e lehtësojë shumë punën, në mënyrë që t'i përcaktojmë prioritetet.

Janë të dhimbshme ngecjet e mëdha në arsim, në shëndetësi e në zbatim të ligjit, mirëpo është fakt i mirë që ne veç kemi filluar t'i pranojmë si reale, nuk jemi duke i mohuar dhe nuk jemi duke i mbyllur sytë para këtyre çështjeve dhe me vetë faktin që po i pranojmë dhe po përcaktojmë që janë reale, atëherë me siguri edhe do t'i ndërmarrim hapat adekuat për përmirësimin e tyre.

Kuvendi është duke u munduar të bëjë punën e vet, jemi të njoftuar me problemet dhe problematikat, të cilat e kanë përcjellë punën e Kuvendit. Kuvendi ka kapacitet dhe ka mundësi të kontribuojë më shumë në monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe ndoshta është koha e fundit që Komisioni ynë me u marrë me monitorimin e zbatimit të detyrave të institucioneve, të cilat ndërlidhen në mënyrë direkte apo indirekte me integritet evropiane.

Shteti ynë ka qenë gjithnjë i kujdesshëm, posaçërisht viteve të fundit, te relacioni i dialogut me Serbinë, ka qenë i kujdesshëm që gjithherë të jetë kontribuues dhe participues, që të përmirësohet ambienti dhe relacioni në mes institucioneve tona dhe fillimisht qytetarëve serbë, po edhe të tjerëve dhe të përmirësojnë njëkohësisht edhe relacionet tona me Serbinë. Ndoshta, gjithherë vullneti për të qenë kontribuues pozitivë në këtë drejtim dhe për të mos qenë gjeneratorë të ndonjë krize, është keqkuptuar ose është keqpërdorë nga Serbia, që gjithherë me nxjerr edhe një problem të ri dhe gjithherë me vendos edhe një pengesë të re, në mënyrë që me i rritur kushtet dhe me i rritë, ndoshta, beneficionet të Bashkimi Evropian në drejtim të tyre, për t'u prezantuar që kinse "qe na tash po lëshojmë pe", të cilat gjatë procesit i kanë ngritur në mënyrë artificiale, ndër to siç është edhe muri. Nuk kisha pasur dëshirë të vazhdojë më shumë për murin, sepse besoj se pjekuria e institucioneve tona në drejtim të zgjidhjes adekuate bashkë me ndihmën e Bashkimit Evropian do të gjejnë solucionin më të mirë të mundshëm në këtë relacion. Mirëpo, qëllimi është i shëndoshë prej institucioneve tona, se ne jemi duke punuar me përkushtim në drejtim të integritetit të serbëve dhe pakicave tjera në institucione dhe në jetën e përditshme.

Ju kisha lutur që të keni parasysh që ta merrni si veprim të mirë pjekurinë e institucioneve tona, mos ta merrni si dobësi ose mos ta merrni si pafuqi edhe me qenë të kujdesshëm, sepse mund të vijnë momente kritike, që edhe qytetarëve tanë u vjen nganjëherë ndonjë moment që s'mund të kontrollojnë veprimet e veta dhe atëherë, mund të shkojë situata jo të favorshme dhe më vështirë të zgjidhshme.

Posaçërisht, në zbatimin e ligjit, besoj se kemi përparuar bukur shumë. Është bërë këtu një përzgjedhje dhe një seleksionim i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Tash janë emëruar edhe disa prokurorë të rinj. Besoj që rritja e numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve ende nuk është numër i mjaftueshëm duke i marrë për bazë krahasimet me numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në shtetet në regjion, krahasuar me numrin e banorëve. Besoj që arritja përafërsisht e kuotave të njëjta, ose të ngjashme me shtetet në rajon të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të ndikojë në zvogëlimin e lëndëve. Ndoshta, kishte me qenë një ndihmë drejtpërsëdrejti që ju ta bëni një vlerësim dhe një evoluim të punës së gjyqësorit dhe prokurorisë në drejtim të metodologjisë së përzgjedhjes së numrit kaq të madh të lëndëve.

Pa dashur ta zgjas më shumë, besoj se do të jenë prioritete politike afatmesme dhe afatgjate, të cilat i kemi përcaktuar dhe do të mundohemi që të zbatojmë edhe pjesët e programit tonë, të cilat dalin prej marrëveshjes për stabilizim- asociim. Ju kishim lutur që gjithherë të na drejtoheni me këshilla, dhe sugjerimet e juaja.

Besoj që është duke u ngritur niveli i kritikës konstruktive edhe prej mjeteve të informimit, por edhe prej qytetarëve, për të gjitha ato problematika, të cilat janë në njëfarë mënyre pengesë për zhvillimin tonë dhe për kualitetin e jetës sonë. Po, gjithherë bazuar në kapacitetet e shtetit tonë dhe në Buxhetin e shtetit tonë besoj që jemi në rrugë të drejtë. Mirëpo ka nevojë për një monitorim më të madh derisa të mbërrijmë në nivel që të jemi përgjegjës për instalimin e institucionit të përgjegjësishë. Besoj që në shtetin tonë më së shumti mungon institucioni i përgjegjësishë, qoftë asaj politike, administrative, gjyqësore, e tjera.

**Bislim Zogaj** falënderoi znj. Apostolova për prezencën dhe shpreson që ky fillim i mirë i bashkëpunimit do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe ky bashkëpunim të çojë deri te rezultatet që do të jenë në favor të qytetarit të Kosovës.

Në vazhdim tha se do të ndalem pak edhe në kritika, sa i përket mungesës së Listës Serbe në seanca dhe komisione. Unë besoj se nuk është fajtorë as Qeveria dhe as Kuvendi, por është dikush tjetër sepse Lista Serbe nuk menaxhohet as nga Kuvendi, as nga Qeveria, por menaxhohet nga Serbia dhe ne, si Kuvend e kemi të vështirë të ndikojmë, që ata të jenë prezent në Kuvend.

Desha të ndalem pak edhe te liria e shprehjes. Shihet aty në Raport të Progresit ku thuhet se ende mungon liria e shprehjes. Unë mendoj se disa sulme që kanë qenë ndaj mjeteve të informimit, si sulmi ndaj shtëpisë së drejtorit të Radiotelevizionit si dhe sulmit ndaj shtëpisë së drejtorit të Radiotelevizionit e dënon çdo qytetarë dhe mos të flasim për të gjitha institucionet. Unë mendoj se shpeshherë liritë e shprehjes shumë herë janë bastarduar, sepse shpeshherë gazetarët i njollosin deputetët dhe institucionet e ndryshme.

Mendoj se është si pasojë sepse edhe me ligj janë privilegjuar gazetarët, mendoj se ndoshta edhe në ligj duhet t'i bëjmë disa ndryshime.

Lidhur me murin e vendosur në Mitrovicë tha se Bashkimi Evropian a është këtu për ta rregulluar situatën apo për ta ndërlikuar, sepse muret në kohën e sotme ne, shqiptarët, që i kemi pasur disa tradita i kemi hequr edhe nëpër oborret tona, kurse tash këta i ndajnë qytetet me mure. Prandaj, besoj se Bashkimi Evropian duhet të jetë pak më realist dhe duhet të marrë masa për ndonjë stabilitet sepse edhe gjeneratat e reja ka mundësi që mos të mund të durojnë veprime të tilla.

**Përfaqësuesja speciale e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalia Apostolova** i konsideroj diskutimet mjaft interesante dhe tha se nuk duhet vetëm te flasim, por edhe të veprojmë. Lidhur me murin e vendosur në Mitrovicë ajo tha : "BE-ja ndërton ura, jo mure, ndërkaq, muri që është ndërtuar në veri të Mitrovicës nuk është projekt i BE-së" dhe BE përkrah ndërtimin e urave, e jo të mureve.

Projekt i Bashkimit Evropian është vetëm rivitalizimi i urës mbi lumin Ibër, ndërsa muri që është ndërtuar pak metra më tutje është projekt tjetër.

Nga ajo që kam vëzhguar, tha më tej ajo, kjo është çështje që duhet të vendoset në dialog mes kryetarëve të komunave dhe përfaqësuesve të BE-së. Lidhur më këtë, ajo është shprehur e bindur se do të gjendet një zgjidhje, duke marrë parasysh se ka të bëjë me një problem mjaft të ndjeshëm politik sepse lëvizja e lirë është esenciale.

Ne jemi duke bërë presion që të respektohen të drejtat e qytetarëve të të gjitha komuniteteve Qëllimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka theksuar ajo, është normalizimi i raporteve ndërmjet këtyre dy vendeve. Duke folur për liberalizimin e vizave, Apostolova theksoi se BE-ja nuk aplikon standarde të dyfishta për Kosovën, por duhet të përmbushen dy kriteret, ai për demarkacionin dhe luftimi i korrupsionit.

Ajo vlerësoi se janë bërë përmirësime në fushën e gjyqësisë. Po ashtu, tha se janë shënuar rezultate edhe në fushën e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar por duhet punuar

edhe më shumë në këtë drejtim. Në lidhje me dialogun në mes Kosovës dhe Serbisë, Apostolova theksoi se ky dialog duhet të vazhdojë dhe se deputet duhet të tregohen konstruktiv në raport me të.

**Kryetarja** falënderoj znj. Apostollova për gatishmërinë e saj që nga fillimi të jetë prezent dhe t'i përgjigjet ftesës për me ardhur në Komision. Falënderoj edhe përfaqësuesit nga projekti i binjakëzimit që ishin prezent, sepse tha se kjo është një mundësi e mirë që ne të përfitojmë eksperiencën nga vende të ndryshme që e kanë kaluar këtë fazë të procesit dhe uroj që kjo nismë, ky bashkëpunim i mirë me Komisionin për Integritet të vazhdojë.

#### **4. Shqyrtimi i Agjendës për Reforma Evropiane (ARE);**

**Kryetarja** tha se Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) paraqet kornizën e dialogut të rregullt që është krijuar për të shtyrë përpara përmbushjen e detyrimeve të MSA-së për mes një qasje ku reformat prioritare do të diskutohen rregullisht përmes palëve në nivelin më të lartë politik. Kjo agjendë ka për qëllim përcaktimin e prioriteteve deri në fund të vitit 2017 për përmbushjen e MSA, veprimet e ARE janë identifikuar bashkërisht nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian.

**Vjosa Osmani** për shkak të rëndësisë së madhe të këtij dokumenti propozoj që të organizohet një takim që zgjat së paku tërë ditën, sepse pasi e shqyrtojmë kemi të drejtë edhe të bëjmë amendamente në këtë dokument para se ta miratojmë përfundimisht. Pra, ne ta shqyrtojmë dokumentin, ta shohim nëse ka nevojë të shtojmë çështje që i konsiderojmë si Kuvend i Kosovës prioritare që nuk janë adresuar si të tilla në ARE dhe t'i propozojmë ato si amendamente, sepse dokumenti final i Republikës së Kosovës do të jetë dokumenti që miratohet nga ky Kuvend. Kujdes të veçantë gjatë shqyrtimit ne, si Komision duhet t'i kushtojmë kujdes të veçantë kategorisë së 3-të që është punësimi dhe edukimi. Pra, duhet të ndalemi të çështja e arsimit, ta marrim raportin e PISA-së dhe të shohim se cilat pjesë duhet të prioritetizohen dhe të bëhen pjesë e ARE-së dhe patjetër si Komision i ngarkuar për shqyrtimin e këtij dokumenti të mos dalim vetëm me një vlerësim paushall që rekomandohet votimi pa asnjë amendament të vetëm.

**Donika Kadaj- Bujupi:** Mendoj që jemi në një moment goxha kritik sepse për deri sa ne po flasim për integritet po na ndërtohen muret në Mitrovicë, na ka marrë kohë më shumë se 8 vjet dialogu dhe në një farë forme kemi pasur një qeveri më tepër për dialog se sa për qytetarë. E konsideroj si tepër të domosdoshme me e ftuar Edita Tahirin, si Komision, në një mbledhje urgjente sepse për ndryshe ne kot po flasim për reforma, e po ndërtojmë mure, të ftohet edhe ministri i Punëve të Brendshme sepse kjo është çështje e brendshme.

**Fatmir Xhelili** pajtohet me deputeten Osmani me e trajtua agjendën në pikë për pikë, ndoshta disa që janë adresua këtu si prioritete duhet së pari me marr informata shtesë se cilat janë kapacitetet e disa institucioneve, mos t'i marrim prioritet nëse nuk janë kapacitetet reale që ne po i përcaktojmë vetë si prioritete dhe ato po hynë si detyra dhe pastaj po dalin se nuk po janë ne gjendje me i krye. Pajtohem që nëpërmes administratës me i bërë disa pyetje institucioneve për të cilat kemi nevojë për informata shtesë.

Kurse sa i përket ftesës për ministra, tha se çdo herë ne po veprojmë në mënyrë reaktive, është aktualizuar muri, por nuk do të ishte mirë për çdo problem me e ftuar ministren Tahiri dhe ministrin e Brendshëm, mendoj se ministrin për dialog ta ftojme në cilësinë për të diskutuar për këtë plan lidhur me detyrat afatmesme dhe afatgjate dhe kishim mundur me diskutua edhe për kapacitetet që i kanë, me ftuar edhe ministrin e Drejtësisë dhe ministrin e Arsimit dhe në paket të diskutojmë për problemet që ndërlidhen me Agjendën Evropiane.

**Time Kadrijaj** pajtohet që të ftohen ministrat dhe së bashku tha ta elaborojmë secilën pikë dhe të shohim se ku mundemi me ndërhye sepse gjendemi në një gjendje të rëndë, e kemi ftuar

kryeministrin në interpelancë, por po shihet se Qeveria nuk e ka gatishmërinë me u përgjigj dhe me sqarua para deputetëve dhe opinionit se çka është duke ndodhur, sepse po ka deklarata të kundërta nga zyrtarët e lartë shtetëror. Duhet një herë e përgjithmonë me u vetëdijesuar kjo Qeveri dhe njëherë me vepruar si shtet, e jo gjithherë me qenë me kokulur para një pakice me 5% dhe me qenë peng i 95% i popullsisë, kjo është e turpshme.

**Kryetarja pas diskutimeve konstatoj se komisioni një zëri nxori këto:**

#### **Përfundime**

1. Të ftohen në Komision ministrja për Dialog, znj. Edita Tahiri dhe ministri për Punë të Brendshme, z. Skender Hyseni për të diskutuar lidhur me procesin e dialogut dhe Integritimit Evropian.

2. Për të diskutuar për Agjendën për Reforma Evropiane (ARE), të ftohen në Komision, ministri për Arsim, z. Arsim Bajrami, ministri për Administratë Publike, z. Mahir Yagcilar, ministrja e Drejtësisë, z. Dhurata Hoxha dhe ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale, z. Arban Abrashi.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja** njoftoi se ashtu siç ishin dakorduar në mbledhjen e fundit të Komisionit lidhur me këtë projektligj kishte biseduar me kryetaren e Komisionit Funkcional ta tërheq lidhur amendamentin 3, ashtu si kemi propozuar.

Lidhur me këtë hapi diskutimin,

Pasi ishte diskutuar në mbledhjen e fundit për këtë projektligj **kryetarja** konstatoj se Komisioni nxori këtë:

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për procedim të rregullt në Kuvend.

#### **6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja** gjatë prezantimit të opinionit ligjor theksoi se Projektligji nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, janë shqyrtuar dhe është konstatuar se fusha që rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Lidhur me këtë Projektligj e hapi diskutimin

**Pasi nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit kryetarja** konstatoj se Komisioni një zëri nxori këtë:

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për procedurë të rregullt në Kuvend.



## **7. Të ndryshme**

**Vjosa Osmani** propozoi që të shikohet mundësia me kërkuar një hulumtim parlamentar për Ligjin për mbrojtjen e informatorëve ose sinjalizuesve i cili në raportin për vendin thuhet se nuk është në përputhje me standardet evropiane, e kam përgatit një kërkesë për hulumtim parlamentar me analizua ligjin ekzistues dhe me shikuar se në cilat pjesë me bërë ndërhyrje, pasi t'i marrim të dhënat kishim mundur si Komision me iniciuar ndryshimin e këtij Ligji.

Në vazhdim tha se pasi tani e kemi raportin për vendin një herë javë kur të takohemi si Komision, te të ndryshme çdo javë me pas nga një iniciativë me i adresua çështjet në drejtim të sfidave të raportit.

**Fatmir Xhelili** tha se pajtohet me propozimin e znj. Osmani, por tha se kemi edhe shumë për të identifikuar si iniciativa që mundemi me i marr si Komision, ta bëjmë vlerësimin por të mos ngarkohemi me detyra e pastaj të dalim që nuk mundemi me i bërë, p.sh. si aktuale, a ka konflikt interesi te gjyqtarët me punuar me ligjëruar nëpër fakultete gjatë orarit të punës e shumë të tjera që në fillim duken të thjeshta, por mos puna e tyre lë pa produkte të mirëfillta në këtë drejtim, nëse i qasemi seriozisht problematikave të cilat i kemi përcaktua si prioritete ne, si Komision, mundemi me bërë punë të mirë, nëse merremi me politikën ditore sot për sot mbesim vetëm në suaza të politikës së brendshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

### **E përgatiti**

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Kryetare e Komisionit,**

-----

**Njomza Emini**